



**A K E P**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE  
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

# RAPORTI VJETOR

# 2011

[www.akep.al](http://www.akep.al)  
[info@akep.al](mailto:info@akep.al)

<b>PARATHËNIE</b>	<b>4</b>
<b>AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE</b>	<b>6</b>
<b>1 PANORAMË E PËRGJITHSHME, TË DHËNA MBI TREGUN</b>	<b>7</b>
1.1 TELEFONIA CELULARE	10
1.1.1 <i>Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut</i>	10
1.1.2 <i>Struktura e përdoruesve celularë 2011</i>	13
1.1.3 <i>Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare</i>	15
1.1.4 <i>Shërbime të reja: 3G</i>	15
1.2 TELEFONIA FIKSE	16
1.2.1 <i>Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut</i>	16
1.2.2 <i>Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelecom</i>	17
1.3 INTERNETI	18
1.3.1 <i>Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet dhe struktura e tyre</i>	18
1.3.2 <i>Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura</i>	20
<b>2 VEPRIMTARIA E RREGULLIMIT EKONOMIK TE TREGUT</b>	<b>21</b>
2.1 ANALIZAT E TREGJEVE	21
2.2 MASAT RREGULLATORE	23
<b>3 VEPRIMTARIA E RREGULLIMIT TEKNIK</b>	<b>25</b>
3.1 ADMINISTRIMIN ME EFEKTIVITET TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE	25
3.2 MIRATIMI I STANDARDEVE DHE TREGUESVE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT	25
3.3 ADMINISTRIMI DHE LIBERALIZIMI I VAZHDUESHËM I DOMAIN-EVE NËN.AL	26
<b>4 VEPRIMTARIA INSPEKTUESE DHE MONITORUESE</b>	<b>27</b>
4.1 VEPRIMTARIA INSPEKTUESE	27
4.2 VEPRIMTARIA MONITORUESE	27
<b>5 VEPRIMTARIA JURIDIKE NË RREGULLIM</b>	<b>28</b>
<b>6 RREGULLIMI I TREGUT POSTAR</b>	<b>28</b>
<b>7 FUNKSIONIMI I AKEP</b>	<b>29</b>
7.1 STRUKTURA DHE BURIMET NJERËZORE	29
7.2 REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË VJETORË TË AKEP	30
7.3 NGRITJA DHE PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE INFORMATIKE DHE IMPLEMENTIMI I SHËRBIMEVE ON-LINE	31

<b>FOREWORD</b>	<b>34</b>
<b>ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS AUTHORITY</b>	<b>36</b>
<b>1 OVERVIEW, DATA ON THE MARKET</b>	<b>37</b>
1.1 MOBILE TELEPHONY	40
1.1.1 <i>Number of subscribers and the market share</i>	40
1.1.2 <i>Structure of users of mobile telephony 2011</i>	43
1.1.3 <i>Average monthly use of mobile services</i>	45
1.1.4 <i>New services: 3G</i>	45
1.2 FIXED TELEPHONY	46
1.2.1 <i>Number of subscribers and market share</i>	46
1.2.2 <i>Average monthly use of Albtelecom services</i>	47
1.3 INTERNET	48
1.3.1 <i>Number of broadband Internet subscribers and their structure</i>	48
1.3.2 <i>Provision of wholesale Internet access and infrastructure</i>	50
<b>2 ECONOMIC MARKET REGULATION ACTIVITY</b>	<b>51</b>
2.1 MARKET ANALYSIS	51
2.2 REGULATORY MEASURES	53
<b>3 TECHNICAL REGULATION ACTIVITY</b>	<b>55</b>
3.1 EFFECTIVE ADMINISTRATION OF FREQUENCY SPECTRUM	55
3.2 APPROVAL OF STANDARDS AND QUALITY OF SERVICE INDICATORS	55
3.3 ADMINISTRATION AND CONTINUOUS LIBERALIZATION OF DOMAINS UNDER .AL	56
<b>4 INSPECTING AND MONITORING ACTIVITY</b>	<b>57</b>
4.1 INSPECTING ACTIVITY	57
4.2 MONITORING ACTIVITY	57
<b>5 JURIDICAL ACTIVITY UNDER REGULATION</b>	<b>58</b>
<b>6 POSTAL MARKET REGULATION</b>	<b>58</b>
<b>7 AKEP FUNCTIONING</b>	<b>59</b>
7.1 ORGANIZATION CHART AND HUMAN RESOURCES	59
7.2 REALIZATION OF ANNUAL FINANCIAL INDICATORS OF AKEP	60
7.3 ESTABLISHMENT AND UPGRADE OF INFORMATION SYSTEMS AND IMPLEMENTATION OF ON-LINE SERVICES	61

## PARATHËNIE

### I nderuar lexues,

Në ditët e sotme, njerëzit dhe bizneset kanë nevojë të jenë më të "lidhur", dhe infrastruktura e telekomunikacioneve i sjell ato më afër dhe më shpejt në lidhje. Komunikimi po ndryshon mënyrën e punës dhe jetesës në shoqëri dhe tregu i telekomunikacioneve konsiderohet si lokomotive e çdo ekonomie kombëtare.

AKEP, duke qenë një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregun e telekomunikacioneve në vend, punon për nxitjen e konkurrencës, krijimin e një klime të favorshme për investime në infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe prezantimin e teknologjive të reja për një cilësi të lartë dhe kosto të përballueshme të produkteve për konsumatorët e këtyre shërbimeve.

Puna e AKEP në vitin 2011, ishte vazhdim i asaj të vitit 2010, ku përballimi i sfidave të prezantuara solli risi në tregun e telekomunikacioneve në vend:

- ▶ ofrimin për herë të parë në Shqipëri të shërbimeve të standardit 3G nga "Vodafone Albania" më 10 Janar 2011, dhe
- ▶ implementimin e Portabilitetit të Numrit më 2 Maj 2011, me impakt në rritjen e konkurrencës efikente në prezantimin e paketave dhe planeve tarifore të ulëta për përdoruesit e shërbimeve celulare.

Në vitin 2011, tregu i komunikimeve elektronike vazhdoi të rritet në tre segmentet e tij: telefoninë e lëvizshme, fikse dhe të Internetit.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 5.2 milion, me një rritje prej 15% krahasuar me vitin 2010, i cili përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 185%, që është shumë më e lartë se niveli prej 140% në vitin 2010 apo niveli mesatar në vendet e BE prej 124% në 2010.

Përveç rritjes së numrit të pajtimtarëve, rritje ka patur dhe përdorimi i shërbimeve celulare. Konsumi mesatar i thirrjeve është rritur me 4-5%, ndërsa përdorimi i SMS-ve është rritur ndjeshëm me 21%. Në vitin 2011, një përdorues celular ka kryer mesatarisht 177 minuta komunikim në muaj dhe ka dërguar rreth 12 SMS në muaj.

Reduktimi i ndjeshëm i tarifave celulare në vitet e fundit, si rezultat i ndërhyrjeve në këto tarifa nga AKEP si dhe nga konkurrenca më e lartë në treg, ka përmirësuar pozicionin e Shqipërisë në krahasim me vendet e BE duke e çuar rreth niveleve mesatare të këtyre shpenzimeve edhe më të ulëta (nga nivelet maksimale deri në vitin 2008). Me prezantimin e portabilitetit të numrit, ky pozicion është përmirësuar në vitin 2011.

Dhënia e autorizimit të dytë individual, për përdorimin e frekuencave për ofrimin e shërbimeve të standardit 3G operatorit "AMC" në Shtator 2011, shihet si premisë për rritjen e përdorimit të shërbimeve me brez të gjerë (broadband) në vend.

Në fund të vitit 2011, u konstatua rritje e lehtë e segmentit të telefonisë fikse, duke e çuar normën e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri në 12% krahasuar me 10% në vitin 2010.

Trendi aktual i penetrimit të telefonisë fikse, rritja e konkurrencës nga operatorët alternativë si dhe prezantimi i shërbimeve fikse nga operatorët celulare, sjell optimizëm



në rritjen e këtij segmenti tregu.

Gjatë vitit 2011, janë vënë re dhe disa ndryshime cilësore dhe reduktime të tarifave në ofrimin e aksesit broadband në Internet: rritje e penetrimit, rritje e shpejtësisë së aksesit në Internet, reduktim i tarifave, si dhe rritje e konektivitetit ndërkombëtar.

Për të ardhmen, angazhimet tona përqasen me objektivat e Qeverisë për një “Shqipëri Dixhitale”.

Aksesi në broadband tashmë është bërë një çështje e ditës, është problemi më madhor që ka sektori i komunikimeve elektronike që lidhet me perspektivën e afërt dhe të largët të zhvillimit të sektorit, dhe indikator kryesor i zhvillimit të një vendi modern.

Nuk mund të këtë një përdorim masiv, një transformim të marrëdhënieve të çdo institucioni me publikun pa një rrjet të zhvilluar të transmetimit të të dhënave. Të gjitha projektet dhe aplikimet on-line që po prezantohen me një shpejtësi shumë të madhe, mbase dhe jashtë parashikimeve të disa viteve më pare, kërkojnë bandwidth, kërkojnë kapacitete si brenda vendit ashtu dhe në lidhjet ndërkombëtare.

AKEP, si institucion që rregullon një treg avantgarde në ndryshime, po punon për të kaluar në *e-Authority* ku konsumatorët e shërbimeve të AKEP do t’i përfitojnë ato të gjitha online.

Së fundmi, më lejoni t’ju paraqes Raportin Vjetor, i cili përmban aktivitetet, ngjarjet dhe zhvillimet më të rëndësishme të ndodhura në sektor gjatë 2011, duke Ju siguruar se AKEP do të përmbushë në vazhdimësi rolin e vet rregullator në sektor, me qëllim inkurajimin e investimeve dhe dhënien e garancive për konkurrencë efëcente dhe përfitime për konsumatorin.

Sinqerisht,

KRYETAR

## AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE



Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare [AKEP] është organi rregullator në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator të përcaktuar nga ligji për komunikimet elektronike, nga ligji për shërbimin postar dhe nga politikat e zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

AKEP është person juridik, publik, jobuxhetor, i cili drejtohet nga Këshilli Drejtues që është i pavarur në marrjen e vendimeve dhe funksionon në bazë të rregullores së brendshme, të miratuar nga ai vetë. Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rizgjedhje jo më shumë se 1 herë. Kuvendi cakton Kryetarin ndërmjet anëtarëve të Këshillit Drejtues, i cili është drejtuesi ekzekutiv i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Kompetencat dhe detyrat e AKEP përcaktohen në Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë dhe Ligjin nr. 10132, datë 11.05.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 8530, datë 23.09.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”.

### MISIONI

AKEP është një rregullator i pavarur dhe pararendës për tregjet e telekomunikacioneve dhe postare duke kërkuar të arrijë një kuadër rregullator që nxit një mjedis të favorshëm për investitorët dhe ofron zgjidhje, çmim dhe cilësi më të mirë për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të telekomunikacioneve dhe postare në Shqipëri.

# 1 PANORAMË E PËRGJITHSHME, TË DHËNA MBI TREGUN

Numri i sipërmarrësve të regjistruar për ofrim rrjetesh apo shërbimesh publike të komunikimeve elektronike gjatë vitit 2011, ka qenë pothuajse i njëjtë me atë të vitit 2010. Referuar “Regjistrin të Sipërmarrësve” numri i sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike deri në fund të vitit 2011 ishte 202 në krahasim me 196 deri në fundvitin 2010 dhe përkatësisht:

- ▶ Ofrim shërbimi publik telefonik të lëvizshëm – 4 sipërmarrës, i njëjtë me vitin 2010;
- ▶ Ofrim shërbimit publik telefonik fiks (të qëndrueshëm) – 79 sipërmarrës, kundrejt 82 në vitin 2010;
- ▶ Ofrim shërbimi të aksesit në Internet – 130 sipërmarrës, kundrejt 116 në vitin 2010;
- ▶ Ofrim shërbimi me vlerë të shtuar – 48 sipërmarrës, kundrejt 43 në vitin 2010;
- ▶ Ofrim të linjave me qera – 30 sipërmarrës, kundrejt 37 në vitin 2010.

Gjatë vitit 2011, janë regjistruar 35 sipërmarrës të rinj, ndërsa 17 sipërmarrës kanë kërkuar mbylljen e të gjitha rrjeteve dhe shërbimeve.

Gjithashtu, kanë njoftuar mbyllje të një ose disa shërbimeve 36 sipërmarrës kryesisht shërbimin e transmetimit të të dhënave.

Me qëllim lehtësimin e procedurave dhe rritjen e transparencës në trajtimin e njoftimit dhe konfirmimin e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike nga subjektet, gjatë vitit 2011, AKEP ka punuar në hartimin e një rregullore të re “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, duke e shoqëruar me aplikacionin përkatës online.

## Tregues Financiarë

Të ardhurat totale të sipërmarrësve në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2011 ishin 51922 milion Lek të cilat përbëjnë një reduktim prej rreth 9% në krahasim me vitin 2010 kur të ardhurat ishin 57087 milion LEK. Ky reduktim i të ardhurave është në tendencë të kundërt me volumin e shërbimeve të cilat janë rritur ndjeshëm gjatë vitit 2011 (Internet dhe telefoni celular).


Reduktimi i të ardhurave të sektorit rezulton të jetë kryesisht si pasojë e reduktimit të të ardhurave të operatoreve celulare gjatë vitit 2011, të ardhura të cilat ishin 39.2 miliard lekë, që përbën një reduktim prej 6% në krahasim me vitin 2010, kur të ardhurat ishin 41.9 miliard lekë. Ndërkohë rënie në të ardhura kanë pasur edhe Albtelecom dhe operatorët alternative në total.

Peshën kryesore të të ardhurave të sektorit edhe për vitin 2011 vazhdojnë ta mbajnë operatorët celularë dhe Albtelecom, të cilët së bashku zotërojnë rreth 93% të të ardhurave të të gjithë sektorit, ndërsa operatorët e tjerë (Operatorët Alternativë) zotërojnë rreth 7% pjesë tregu (rënie nga niveli 8% në 2010). Të ardhurat e operatorëve celularë përbëjnë rreth 75% të të ardhurave të të gjithë tregut (rritje nga 73% e 2010


për të njëjtët tregues të krahasuar], ndërsa operatori fiks Altelecom zotëron 18% të të ardhurave të sektorit (një rënie e vogël prej rreth 1 pikë përqindje në krahasim me 2010).

Sipërmarrësit alternative ndër më kryesorët sipas të ardhurave mund të vlerësohen operatorët ABCom, Primo, ASC, Abissnet, Nisatel dhe Info Telecom të cilët së bashku zënë rreth 5% të të ardhurave të sektorit, apo rreth 80% të peshës totale të të ardhurave të operatorëve alternativë.

**Figura 1** Të ardhurat totale të operatorëve të komunikimeve Elektronike (2011)




**Figura 2** Ecuria e të ardhurave totale të operatorëve të komunikimeve elektronike (2008-2011)





**Figura 3** Pjesët e tregut në të ardhura të operatorëve alternativeë në tregun e komunikimeve elektronike për vitin 2011



## Investimet

Përsa u përket investimeve të kryera në vitin 2011, tabela e mëposhtme paraqet të dhënat sipas deklarimeve të operatorëve. Rritje të ndjeshme në krahasim me 2010 paraqesin investimet në rrjete fikse dhe fibrat optike për rrjete backbone.

**Tabela 1** Investimet e operatorëve të komunikimeve elektronike (2011)

	2010	2011
Investime në infrastrukturë në rrjetet fikse:	<b>1,820</b>	<b>3,254</b>
Rrjet telefonik PSTN/ISDN	524	427
Rrjet IP (ISP), platforma IP	222	1,434
Infrastrukturë rrjet backbone FIBER OPTIKE	1,074	1,393
Investime në infrastrukturë rrjeti celulare	<b>8,089</b>	<b>6,831</b>
Total	9,909	10,085

## Të punësuar

Numri i të punësuarve me kohë të plotë nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike në vitin 2011 ishte 4166 që përbën një rënie të vogël në krahasim me 2010 (4240). Shpërndarja sipas gjinisë tregon se në vitin 2011, 45% e të punësuarve ishin femra. Sipërmarrësi me numrin më të madh të të punësuarve është Albtelecom me 36% të të

gjithë të punësuarve në tërë sektorin.

**Figura 4** Shpërndarja e të punësuarve në sektorin e komunikimeve elektronike 2011




Tabela e mëposhtme paraqet numrin e të punësuarve në sektorin e komunikimeve elektronike në fund të vitit 2011.

**Tabela 2** Numri i të punësuarve në sektorin e komunikimeve elektronike (2011)

	Operatorë Celularë	Albtelecom	Operatorë Alternativë	Total
Të punësuar me kohë të plotë	1700	1491	975	4166
Prej të cilëve femra	941	597	314	1852

## 1.1 TELEFONIA CELULARE

### 1.1.1 Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut


Në fund të vitit 2011, numri i pajtimtarëve të telefonisë së lëvizshme arriti në afërsisht 5.2 milion, e cila përbën një normë penetrimi (numri i përdoruesve për 100 banorë) prej 185%, një shifër shumë më e lartë se niveli prej 140% në vitin 2010, apo niveli mesatar në vendet e BE prej 124% në 2010. Numri i pajtimtarëve celularë i referohet numrit të kartave SIM aktive, dhe politikat e operatorëve janë që një kartë SIM mund të jetë aktive për një vit nga momenti kryerjes së thirrjes së parë, dhe nëse koha e bisedës përfundon para aftit 1 vjeçar pajtimtari mund të marrë thirrje hyrëse për 6 muaj. Ndërkohë nëse do ti referoheshim numrit të pajtimtarëve që kanë kryer komunikim në tre muajt e fundit (aktive), numri i pajtimtarëve celularë në fund të vitit 2011, do të ishte 3,108,087 (norma e penetrimit 110%) krahasuar me 3,157,404 në fund të 2010. AKEP gjykon se

ndryshimi në vlerat e cituara më sipër ndodh për shkak se në shifrën e numrit të kartave SIM referuar më sipër ka një numër të konsiderueshëm pajtimtarësh me përdorim sezonal, si p.sh emigrantë apo vizitorët në Shqipëri, si edhe një numër pajtimtarësh që mund të mos e përdorin më një kartë SIM, megjithëse ajo rezulton aktive. AKEP, këtu i referohet numrit të kartave SIM aktive si numri i pajtimtarëve celularë, pasi kjo është praktikë që ndiqet edhe në vendet e tjera.

Norma vjetore e rritjes së numrit të përdoruesve ishte rreth 15% (rreth 690 mijë përdorues më shumë), që është më e lartë se norma vjetore e rritjes prej 9% në vitin 2010. Gjatë vitit 2011 rritje më të madhe ka pasur operatori më i ri në treg Plus Communication me rreth 370 mijë pajtimtarë më shumë se 2010, i pasuar nga Eagle Mobile me rreth 290 mijë apo 35% rritje dhe Vodafone me 8% rritje vjetore. AMC operatori më i madh në treg për sa i përket numrit të pajtimtarëve ka pasur reduktim me 5% të tyre.

Të ardhurat totale të katër operatorëve celularë gjatë vitit 2011 ishin 39.2 miliard lekë, që përbën një reduktim prej 6% në krahasim me vitin 2010, kur të ardhurat ishin 41.9 miliard lekë.

**Figura 5** Të ardhurat dhe pjesët e tregut të operatorëve celularë (2011)




Në figurën e mëposhtme paraqitet tendenca e të ardhurave celularë në periudhën 2003-2011, ku mund të vihet re se në vitin 2011 ka pasur një rënie të të ardhurave në krahasim me vitin e mëparshëm 2010.

Gjatë 2011 rënie më të madhe ka pasur AMC me 20% dhe Eagle me 6%. Ndërsa Vodafone ka pasur ndryshim të vogël me rritje prej 1%.

Plus, si operatori më i ri ka pasur rritje të madhe me rreth 75 herë, por duhet marrë në

konsideratë se për vitin 2010 Plus ishte në treg për vetëm 1 muaj.


**Figura 6** Të ardhurat e operatorëve celularë 2003-2011



	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Vodafone	13,266	17,007	19,605	21,483	23,075	24,919	22,877	20,165	20,347
AMC	15,526	17,106	18,326	19,811	21,785	23,471	19,975	16,552	13,214
Eagle						600	4,362	5,166	4,865
Plus								10	751

Milion Lek

Figura e mëposhtme paraqet pjesët e tregut për vitin 2011 për disa tregues kryesorë. Nga grafiket mund të vëmë re AMC zotëron pjesë tregu më të madhe për numër pajtimtarësh me 37%, ndërsa për të ardhurat zë 34%, thirrje dalëse 37% dhe SMS 37%, ndërsa Vodafone ka pjesë më të mëdha tregu për volume të ardhurash 52%, ndërsa për thirrje dalëse 51% dhe SMS 51% respektivisht. Eagle Mobile ka arritur në 21% pjesë tregu për numrin e pajtimtarëve dhe 12% pjesë tregu për të ardhurat, 10% pjesë tregu për thirrjet dalëse dhe SMS, ndërsa Plus rreth 8% për numër pajtimtarësh, 2% në të ardhura dhe 2% në SMS.

**Figura 7** Pjesët e tregut të operatorëve celularë (2011)

### 1.1.2 Struktura e përdoruesve celularë 2011

Struktura e përdoruesve celularë, në përdorues me parapagim dhe me paspagim [kontrate], vazhdon të jetë e qëndrueshme ndër vite. Në vitin 2011, 91% e pajtimtarëve ishin përdorues me parapagim. Në përgjithësi, kjo strukturë është e ngjashme për të katër operatorët celularë, megjithëse Eagle Mobile ka rreth 14% të përdoruesve total me kontratë për vitin 2011, në ndryshim nga tre operatorët e tjerë që kanë 6-8% të përdoruesve total me kontratë.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat statistikore për vitin 2011, mbi numrin e pajtimtarëve celularë të detajuar në pajtimtarë “Familjarë” dhe “Biznes” si dhe përdorues të shërbimeve të internetit sipas aksesit në 2G dhe 3G, numrin e pajtimtarëve që kanë ndërruar operator duke përdorur shërbimin e portabilitetit të numrit, si dhe numrin e pajtimtarëve që kanë ndërruar programet tarifore në rrjetet celulare për vitin 2011 sipas operatorëve.

**Tabela 3** Detajimi i pajtimtarëve celulare 2011

<b>Detajime për pajtimtarët e telefonisë celulare</b>	<b>AMC</b>	<b>VF-AL</b>	<b>EAGLE</b>	<b>PLUS</b>
<b>Numri pajtimtarëve të telefonisë celulare në total i detajuar:</b>	<b>1,920,000</b>	<b>1,809,264</b>	<b>1,110,363</b>	<b>396,722</b>
Përdorues familjarë	1,804,800	1,767,303	911,493	369,368
Përdorues biznes	115,200	41,961	198,870	27,354
<b>Numri i pajtimtarëve që përdorin rrjetin celular për akses në internet me GPRS/EDGE</b>	<b>779,805</b>	<b>267,788</b>	86,492	70,955
<b>Numri pajtimtarëve të telefonisë mobile me akses në Internet broadband UMTS në total:</b>	<b>55,000</b>	<b>228,249</b>		
- nëpërmjet aparatit të telefonit celular	46,000	<b>202,756</b>		
- nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	9,000	<b>25,493</b>		
<b>Numri i Pajtimtarëve që kanë ndërruar program tarifor</b>	<b>56,173</b>	<b>139,752</b>	<b>107,505</b>	<b>3,672</b>
<b>Numri i pajtimtarëve që kanë ndërruar operator (portabilitet numri)ë Numri neto: IN -OUT</b>	<b>-4553</b>	<b>8561</b>	<b>3699</b>	<b>-7707</b>
nga rrjete të tjera celulare në rrjetin tuaj (port IN)	9,575	<b>18,571</b>	9,267	2,445
nga rrjeti juaj në rrjete të tjerë celulare (port OUT)	14,128	<b>10,010</b>	5,568	10,152

### 1.1.3 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Në vitin 2011, ka vazhduar tendenca e rritjes së përdorimit mesatar të thirrjeve telefonike që ka filluar në vitin 2009, megjithatë kjo rritje ka qenë shumë më e vogël se rritja e madhe në 2009 dhe 2010. Konsumi mesatar i thirrjeve është rritur me 4-5%, ndërsa përdorimi i SMS-ve është rritur ndjeshëm me 21%. Në vitin 2011, një përdorues celular ka kryer mesatarisht 83 minuta thirrje dalëse dhe ka marrë 94 minuta thirrje hyrëse, duke rezultuar në 177 minuta komunikim në muaj dhe ka dërguar rreth 12 SMS në muaj.

**Tabela 4** Përdorimi i shërbimeve celulare 2010-2011

	2010	2011	Ndryshimi%
<b>Thirrje dalëse në muaj</b>	80	83	4%
<b>Thirrje të marra (hyrëse) në muaj</b>	90	94	5%
<b>MOU<sup>1</sup></b>	170	177	4%
<b>SMS (dalëse) në muaj</b>	10	12	21%

### 1.1.4 Shërbime të reja: 3G

Më datë 10 Janar 2011, Vodafone Albania lançoi për herë të parë shërbimet 3G në Shqipëri dhe AMC shumë shpejt pasi mori të drejtën filloi ofrimin e shërbimeve 3G në fund të 2011. Nga të dhënat e tabelës së mëposhtme mund të vihet re se numri i pajtimtarëve që përdorin shërbimet 3G në të dy rrjetet është rreth 280 mijë.

Njëkohësisht përdoruesit me karta modem/USB 3G që lejon aksesin në internet nëpërmjet PC është rreth 34 mijë që përbën 20% të pajtimtarëve total (fiks dhe 3G) me akses broadband në Shqipëri. Pra, në një periudhe kohore më pak se një vit përdorimi i shërbimeve duket se është i kënaqshëm. Njëkohësisht me hyrjen në treg të AMC është vënë re edhe reduktim i tarifave për shërbimet 3G.

**Tabela 5** Tregues të ofrimit të shërbimeve 3G (2011)

	AMC	VODAFONE	TOTAL
Numri pajtimtarëve të telefonisë mobile me akses në Internet broadband UMTS në total:	<b>55,000</b>	<b>228,249</b>	<b>283,249</b>
- nëpërmjet aparatit të telefonit celular	<b>46,000</b>	<b>202,756</b>	<b>248,756</b>
- nëpërmjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)	<b>9,000</b>	<b>25,493</b>	<b>34,493</b>

<sup>1</sup>Minutes Of Use: Minuta përdorimi të matura me shumën e thirrjeve dalëse dhe hyrëse

## 1.2 TELEFONIA FIKSE

### 1.2.1 Numri i pajtimtarëve dhe pjesët e tregut

Në vitin 2011, telefonia fikse në ndryshim nga vitet e fundit ka shënuar rritje në numrin e pajtimtarëve. Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të vitit 2011, arriti në rreth 339 mijë, nivel i cili përbën një rritje me rreth 7000 pajtimtarë apo 2.2% në krahasim me rreth 332 mijë në fund të vitit 2010. Norma e penetrimit të telefonisë fikse në Shqipëri arriti në 12% krahasuar me 10% në vitin 2010, megjithatë ky nivel është ende shumë i ulët krahasuar me vendet e BE (me një mesatare prej 45%) dhe vendet e rajonit.

Gjatë vitit 2011, numri i pajtimtarëve të Albtelcom është reduktuar (si edhe në 2010) me rreth 19 mijë apo 7% në krahasim me 2010, ndërkohë numri i pajtimtarëve të operatorëve alternativë fiks është rritur me 26 mijë apo 49% krahasuar me vitin 2010.


Albtelcom në fund të vitit 2011, kishte rreth 259 mijë pajtimtarë ndërsa operatorët alternativë rreth 80 mijë. Rënia e numrit të pajtimtarëve të Albtelcom dhe rritja e numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternative ka çuar në reduktimin e pjesës së tregut të Albtelcom nga 84% në 2010 në 76% në 2011.

Sipas të dhënave ABCom, ASC, Nisatel, Primo dhe AMC Fiks (që ka filluar në Dhjetor 2011 ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse me numra fiks duke përdorur rrjetin GSM) janë pesë operatorët alternativë më të mëdhenj që zotërojnë rreth 67% të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse të operatorëve alternative. ABCom dhe ASC kanë rritjen më të madhe vjetore me 36% dhe 37% respektivisht, si edhe AMC që për vetëm 1 muaj aktivitet në ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse me numra fiks duke përdorur rrjetin GSM ka arritur të kapë 2% pjesë tregu. ABCom vazhdon të jetë operatori më i madh alternativ fiks me rreth 27 mijë pajtimtarë. Vlen të theksohet se ABCom dhe ASC si dy operatorët alternativë më të mëdhenj janë prezent në treg me oferta “triple play” duke ofruar Internet broadband, telefoni dhe TV.

**Tabela 6** Shpërndarja e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse (2010-2011)

	Albtelcom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	AMC Fiks	OA të tjerë	Total
<b>2010</b>	277,763	19,975	7,408	5,900	3,678		16,778	331,502
<b>2011</b>	258,943	27,167	10,129	4,950	3,300	7,565	26,790	338,844
<b>Ndryshimi</b>	-7%	36%	37%	-16%	-10%		60%	2.21%



**Figura 8** Pjesët e tregut të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse (2011)

### 1.2.2 Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelcom

Konsumi i thirrjeve hyrëse dhe dalëse nga një përdorues i Albtelcom ishte në rritje në krahasim me vitin 2010 dhe vitet e mëparshme, duke ndryshuar kështu trendin në rënie deri në fund të 2009. Kjo rritje reflektohet dhe tek MOU.

**Tabela 7** Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve të Albtelcom 2008-2011

	2008	2009	2010	2011
Thirrje dalëse	<b>164</b>	<b>136</b>	<b>151</b>	<b>179</b>
Lokale dalëse	136	112	112	135
Celulare	11	10	7	9
Kombëtare drejt fiks	9	41	21	21
Ndërkombetare	6	5	4	6
Thirrje të marra	<b>191</b>	<b>181</b>	<b>204</b>	<b>207</b>
MOU	<b>355</b>	<b>317</b>	<b>356</b>	<b>386</b>

Mesatarisht konsumi i thirrjeve të kryera është 179 minuta në muaj thirrje dalëse si dhe 207 minuta në muaj thirrje të marra, që do të thotë që një përdorues i Albtelecom gjatë vitit 2011 ka shpenzuar mesatarisht 386 minuta apo afërsisht 6.5 orë në komunikim me telefon fiks.

## 1.3 INTERNETI

### 1.3.1 Numri i pajtimtarëve me akses broadband në Internet dhe struktura e tyre

Sipas të dhënave të vitit 2011, nga Albtelecom, operatorët alternative, Vodafone dhe AMC për numrin e pajtimtarëve me akses në broadband 3G (me karta USB/modem) si dhe vlerësimeve të AKEP, rezulton që numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 161 mijë apo afërsisht 22% e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë mbi 13.000 pajtimtarë biznesi. Bazuar në këto të dhëna, numri i lidhjeve me akses broadband (fiks dhe 3G-USB/modem) për 100 banorë është rreth 6.2%, krahasuar me 3.7% që ishte në fund të vitit 2010.

Gjatë vitit 2011, rritje të ndjeshme në lidhjet broadband kanë patur operatorët alternativë dhe dy operatorët celulare Vodafone dhe AMC, ndërsa Albtelecom ka pësuar rënie të numrit të lidhjeve broadband. Nder operatorët alternativë fiks, ABCom vazhdon të jete operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 30 mijë në fund të vitit 2011, që përbën një rritje prej 116% nga viti 2010. Pjesa e tregut e ABCom për aksesin broadband fiks është rritur nga 11% në 2010 në 21% në 2011, dhe është gjithashtu operatori i dytë më i madh për lidhjet broadband fikse dhe celulare me 17% pjesë tregu. Rritje të madhe ka edhe operatori i dytë alternativ më i madh ASC me 79% duke zënë 7% pjesë tregu për aksesin broadband fiks dhe 6% për broadband fiks dhe celular.

**Tabela 8** Shpërndarja e numrit të pajtimtarëve me akses broadband (2010-2011)

	Albtelecom	Abcom	ASC	Nisatel	Primo	Bleta	OA të tjerë	AMC	Vodafone	Total
<b>2010</b>	70,597	13,575	5,666	2,600	4,928	3,000	21,351			121,717
<b>2011</b>	60,055	29,321	10,129	2,500	4,381	3,500	29,811	9,000	25,493	174,190
<b>Ndryshimi</b>	-15%	116%	79%	-4%	-11%	17%	40%			43%


Albtelecom ka pësuar rënie me 15% të numrit të pajtimtarëve broadband. Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve të operatorëve alternativë dhe reduktimi i numrit të pajtimtarëve të Albtelecom ka çuar në reduktim të ndjeshëm të pjesës së tregut të Albtelecom për aksesin broadband fiks: nga 58% në 2010 në 43% në 2011.

Aksesi broadband nga rrjetet celulare duket se ka filluar të japë efektet pozitive pasi Vodafone që ka rreth 12 muaj në treg dhe AMC me 2 muaj, kanë arritur të kenë rreth 34


mijë abonentë broadband me karta USB/modem 3G, që përbëjnë 20% të numrit total të pajtimtarëve broadband [fiks dhe celularë]. Ndërsa numri i pajtimtarëve celularë të këtyre dy operatorëve që përdorin shërbimin e internetit broadband nëpërmjet aparateve telefonike është rreth 280 mijë në fund të vitit 2011.

**Figura 9** Pjesët e tregut për akses broadband (2010-2011)

#### 2011 Fiks dhe Mobile Broadband



#### 2011 Fiks Broadband



Nga të dhënat e raportuara vihet re se një numër i konsiderueshëm i lidhjeve broadband nga operatorët alternativë kryhet me kombinim fibër optike, kabëll koaksial apo linjë bakri. Ndërkohë rreth 10% e abonentëve ADSL të Altelecom përfitojnë akses në

Internet me MSAN ku lidhja nga centrali telefonik deri në kabinet është me fibër optike dhe më pas me linjë bakri, e cila mund të konsiderohet si FTTN (Fiber To The Node). Albtelecom ka kryer investime të konsiderueshme në NGA duke instaluar një numër të konsiderueshëm MSAN për lidhjen e të gjithë abonentëve me në rrjetin NGA/NGN.

Gjatë vitit 2011, janë vënë re ndryshime cilësore dhe reduktime të tarifave në ofrimin e aksesit broadband në Internet.

Shpejtësia më e përdorur është rritur nga 1-2Mbps në 2-4 Mbps. Rreth 48% e pajtimtarëve me akses broadband fiks kanë shpejtësi 2-4 Mbps dhe rreth 14% kanë akses me 4 Mbps. Gjithashtu operatorët kryesorë kanë oferta edhe për shpejtësi më të larta 4-20 Mbps.

**Tabela 9** Klasifikimi i pajtimtarëve me akses broadband sipas teknologjive 2011

	Alternative	Albtelecom
Shpejtësia e aksesit në Internet	256 kbit/s 20 Mbit/s	2 Mbit/s 12 Mbit/s
Shpejtësia më e përdorur	1-2 Mbit/s	2-4 Mbit/s
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara:		
TV, Internet dhe Telefoni	3947	0

### 1.3.2 Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura

Një faktor i rëndësishëm që ndikon në cilësinë dhe tarifën e aksesit broadband për pajtimtarët është edhe lidhja apo konektiviteti i ISP-ve me Internetin global.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten disa të dhëna në lidhje me infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët për rrjete me fibra optike dhe lidhjen me Internetin global (lidhje me Botën). Nga të dhënat vihet re se konektiviteti me Internetin Global është rritur nga rreth 14 Gbps në fund të vitit 2010 në rreth 30 Gbps në fund të vitit 2011.

**Tabela 10** Të dhëna për infrastrukturën e aksesit në Internet në nivel me shumicë 2011

	Alternative	Albtelecom	Total
Konektiviteti me Internetin Global –Lidhje ndërkombëtare (Gbps)	10	20	30
Fibër Optike e instaluar (gjatësia km)	1822	2837	4659

Ndërkohë, me rritje të ndjeshme paraqitet edhe gjatësia e fibrës optike të instaluar nga operatorët e cila është me shumë se dyfishuar në 2011 [4689 km] në krahasime me 2010 [2161 km].

Shkaku kryesor i këtyre rritjeve pozitive ishte rritja e investimeve në infrastrukturë duke u orientuar drejt fibrës optike siç ishte rritja e kapaciteteve nga Albtelecom dhe operatoreve alternative si ATU që ka instaluar rreth 540 km fibër optike deri në fund të 2011.

Ndërkohë numri i Internet kafeve që marrin akses nga ISP-të, sipas të dhënave të operatoreve është rreth 1100 pa ndryshime të ndjeshme me periudhat e mëparshme.

## 2 VEPRIMTARIA E RREGULLIMIT EKONOMIK TE TREGUT

Rregullimi ekonomik i tregut është aspekti kryesor në veprimtarinë e një autoriteti rregullator dhe me konsekuenca për operatorët dhe përdoruesin. Rregullimi ekonomik ka për bazë analizimin e tregjeve dhe përcaktimin e masave rregullatore me qëllim rritjen e konkurrencës efiçente në ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike.

### 2.1 ANALIZAT E TREGJEVE

AKEP, në përputhje me përcaktimet e ligjit 9918, dhe Rregullores së Analizës së Tregut, miratoi versionet finale të tre dokumenteve të rëndësishëm në lidhje me analizat e tregjeve duke vendosur dhe masat përkatëse për operatorët e përcaktuar me FNT.

Më datë 13.04.2011 AKEP publikoi analizën finale të tregjeve me shumicë të shërbimeve të aksesit në rrjete fikse dhe broadband, që përmbajnë analizat e tregjeve nr. 14 dhe 15, të Rregullores së Analizës së Tregut:

- ▶ Tregun me shumicë të aksesit në infrastrukturën e rrjeteve fizike (përfshirë aksesin e ndarë të pjesëshëm ose të plotë) nga vendndodhje fikse.
- ▶ Tregun me shumicë të aksesit broadband.

Bazuar në këtë analizë tregu, AKEP përcaktoi Albtelecom me FNT në tregjet përkatës të mësipërm duke vendosur detyrimet për transparencën, mosdiskriminimin (publikimin e ofertës referencë RUO), kontrollin e tarifave dhe orientimin në kosto për hapjen e qarkut lokal të Albtelecom për akses të plotë dhe akses të përbashkët [LLU: full unbundled dhe shared access], duke përcaktuar dhe nivelin maksimal të tarifave të aksesit në rrjetin lokal të Albtelecom për LLU.

Ndërkohë për shërbimet akses me shumicë broadband [bitstream] për Albtelecom u vendosën detyrimet për transparencën, mosdiskriminimin dhe dhënien akses me shumicë.

- ▶ Në nivel DSLAM;
- ▶ Në nivel ATM/Ethernet;
- ▶ Në nivel IP
- ▶ Rishitje.

Albtelecom ka detyrimin që të japë akses me shumicë broadband (bitstream) në rrjetin Albtelecom, në terma komerciale, përfshirë tarifat e këtyre shërbimeve. Në rast mosmarrëveshje midis palëve zbatohen parashikimet e ligjit 9918 dhe kuadrit rregullator përkatës.

Albtelecom ka detyrimin që në rast të dhënies akses një operatori për shërbimin me shumicë broadband (bitstream) të përditësojë Ofertën Referencë të aksesit të hapur (RUO) për shërbimin e ofruar duke e bërë të disponueshme edhe për operatorë të tjerë në terma jodiskriminues dhe transparent.

Më 13.04.2011 AKEP publikoi analizën finale të tregjeve me pakicë dhe me shumicë të linjave me qera apo tregjet nr. 7, 12 dhe 13 të Rregullores së Analizës së tregut (apo tregjet nr. 7, 13 dhe 14 të Rekomandimit të KE (2003/311/EC) dhe konkretisht:

- ▶ Tregu me pakicë i minimumit të linjave me qera (i cili përfshin lloje të specifikuar të linjave me qera deri në 2Mb/sek)
- ▶ Tregu me shumicë i segmenteve terminuese të linjave me qera;
- ▶ Tregu me shumicë i linjave kryesore (trunk) të linjave me qera;

Bazuar në këtë analizë tregu AKEP përcaktoi Albtelecom me FNT në tregjet përkatës të mësipërm duke vendosur detyrimet për transparencën, mosdiskriminimin, kontrollin e tarifave dhe orientimin në kosto për linjat me qera shumicë dhe me pakicë. AKEP vendosi nivelin maksimal të tarifave të linjave me qira me shumicë kombëtare në nivelin e kostove BULRAIC, si dhe imponoi reduktime të ndjeshme të tarifave të linjave me qira me shumicë ndërkombëtare me 62-64%. Ndër detyrimet e tjera vlen të përmendet detyrimi për dhënie akses për linja me qira me kapacitete të larta si 34 dhe 155 Mbps (më parë maksimumi ishte 2 Mbps) si dhe vendosja e afateve për ofrimin e linjave me qira duke marrë në konsideratë rekomandimet e KE.

Më 5.07.2011, AKEP publikoi për konsultim publik analizën e tregjeve me shumicë të terminimit të mesazheve SMS në rrjetet celulare dhe më 31.10.2011 mori vendimet përkatëse për shpalljen me FNT të AMC, Eagle Mobile, Plus Communication dhe Vodafone Albania në terminimin e SMS-ve në rrjetet e tyre. Me përcaktimin me FNT, u vendosën masat rregulluese me detyrime për mosdiskriminim, transparencë, dhënie akses, kontroll të tarifave dhe orientim në kosto të terminimit të SMS-ve, duke përcaktuar dhe nivelin e tarifave të terminimit të SMS-ve për të katër operatorët te ndare në afate kohore deri me 01.09. 2013.

Tregu me shumicë i terminimit të SMS-ve, nuk është pjesë e Listës së Tregjeve të Rekomandimit të Komisionit Evropian, të vitit 2003 apo të vitit 2007, si dhe nuk është as pjesë e listës së tregjeve në Rregulloren e Analizës së Tregut të miratuar me VKD Nr. 747

datë 17.09.2009. Megjithatë rregullorja, ashtu si edhe rekomandimet e KE, parashikojnë që AKEP mund të analizojë tregje që nuk janë pjesë e listës së tregjeve të justifikuar për ndërhyrje exëante apo për analizim të tyre. Në përputhje me përcaktimet e rregullores dhe rekomandimet e KE, para analizimit të tregut të terminimit të SMS-ve për FNT, AKEP ka provuar se ky treg plotëson tre kriteret që justifikojnë ndërhyrjen në këtë treg.

## 2.2 MASAT RREGULLATORE

### Zgjedhja dhe Parazgjedhja e bartësit

Zgjedhja e Bartësit (ZB) dhe Parazgjedhja e Bartësit (PB) i krijon mundësinë përdoruesve fundorë të një rrjeti të komunikimeve telefonike publike<sup>2</sup> që duke përdorur linjën telefonike të operatorit të rrjetit publik telefonik (ofruesi i aksesit) me të cilin kanë një kontratë pajtimi, të zgjedhin vetë ofruesin e thirrjeve telefonike që i konsiderojnë më të mirat për nevojat e tyre, veçanërisht për sa i përket çmimit dhe cilësisë së thirrjeve telefonike. Në këtë mënyrë krijohet mundësia për një konkurrencë më të madhe midis operatorëve për ofrimin e thirrjeve telefonike duke rritur përfitimet e përdoruesve fundorë për tarifa më të lira për thirrjet telefonike.

Në periudhën 24.02.2011–30.04.2011, AKEP zhvilloi konsultim publik për implementimin e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit (Z[P]B) të thirrjeve, dhe me 29.06.2011, miratoi Rregulloren dhe Udhëzimin për implementimin e Zgjedhjes dhe Parazgjedhjes së Bartësit. Dokumentacioni i miratuar përmban rregullat për implementimin e Z[P]B dhe udhëzime për palët e interesuara, meqenëse Z[P]B është një praktikë e re për tregun në Shqipëri, ndërsa rregullorja normon marrëdhëniet midis palëve të përfshira në proces: ofruesit të aksesit për Z[P]B, bartësit të thirrjeve dhe pajtimtarit. Dokumenti shoqërues përcaktoi Albtelecom si operatori që ka detyrimin të ofrojë Z[P]B si dhe implementimin me faza të Z[P]B. Implementimi i këtij detyrimi kryhet nga Albtelecom nëpërmjet amendimit të RIO, për përfshirjen e shërbimit Z[P]B në RIO.

### Implementimi i LLU

